

VENDIM
Nr. 151, datë 29.2.2012

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJAVE KRYESORE TË DËRGIMIT TË SISTEMEVE TË KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA TË LEZHËS DHE SHËNGJINIT PËR NË ITUP-IN E QYTETIT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjave kryesore të dërgimit të sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza të Lezhës dhe Shëngjinit për në ITUP-in e qytetit të Lezhës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 680 (një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) m², vlerësuar me çmimet e AKKP-së, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 719 040 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 340 000 (treqind e dyzet mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 719 040 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2012, zëri “Kosto lokale”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.

7. Pronarët e pasurive të ndodhura në zonën kadastrale nr. 8270, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi për pronarët sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të rifreskuar që do të dorëzojnë pronarët.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë, në bashkëpunim me Ujësjellës-Kanalizime, sh.a., Lezhë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së shpronësimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Ujësjellës-Kanalizime, sh.a., Lezhë.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Lezhë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së shpronësimit në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, Ujësjellës-Kanalizime, sh.a., Lezhë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Lezhë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha